



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Tiranë, më 22.01.2020

RAPORT

PËR

“PËR RATIFIKIMIN E KONVENTËS SË MINAMATËS “PËR MËRKURIN””

Hyrje

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e datës 22.01.2020, mori në shqyrtim projektligjin “Për Ratifikimin e Konventës së Minamatës “Për mërkurin””. Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut caktoi relator për shqyrtimin e këtij projektligji deputetin Jurgis Cyrbja.

Në mbledhjet e Komisionit për të mbrojtur projektligjin dhe për të dhënë shpjegime për pyetjet e anëtarëve të Komisionit ishin të pranishëm dhe përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për Mjedisin.

I. BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës, sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

Ratifikimi i kësaj marrëveshje bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kreu II “Marrëveshjet Ndërkombëtare”, neni 121 i saj.

II. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT DHE PËRMBAJTJA E TIJ

Qëllimi i këtij projektligji është të finalizojë procesin e ratifikimit të konventës së Minamatës “Për mërkurin”, detyrim ky që rrjedh në kuadër të angazhimeve kombëtare dhe ndërkombëtare që vendi ynë ka në lidhje me adresimin e problematikave për mërkurin.

Konventa e Minamatës është miratuar, në parim, nga Republika e Shqipërisë nëpërmjet vendimit nr.663, datë 8.10.2014, të Këshillit të Ministrave, dhe vetë konventa ka hyrë në fuqi me 16 gusht 2017. Pas nënshkrimit të konventës, vendi ynë përfitoi nga instrumentet financiare

të Fondit Global për Mjedisin (GEF), për zbatimin e kërkesave të saj. Aktualisht, konventa e Minamatës “Për merkurin”, është firmosur nga 128 shtete dhe ratifikuar nga 105 shtete.

Procesi i ratifikimit të kësaj konvente nga Republika e Shqipërisë ka si qëllim mbrojtjen e shëndetit dhe mjedisit nga çlirimet dhe shkarkimet antropogjenike të merkurit dhe do të finalizojë procesin e adresimit të:

1. problemeve që shkakton në mjedis dhe në atmosferë lëshimi i pakontrolluar i mbetjeve teknologjike që përmbajnë merkur;
2. kontrollit dhe marrjes së masave për reduktimin e merkurit në produkte, procese dhe në industritë që përdorin, çlirojnë ose shkarkojnë merkur;
3. hartimit të legjislacionit dhe ngritjes së kapaciteteve institucionale për mbrojtjen e shëndetit e të mjedisit nga mercuri dhe përbërjet e tij;
4. bashkëpunimit ndërinstitucional dhe midis sektorëve të ndryshëm për evidentimin e zonave të mundshme të ndotura me merkur, produkteve dhe proceseve që përfshijnë merkurin, alternativat e mundshme për mbrojtjen e shëndetit e të mjedisit nga mercuri, rehabilitimin e tyre, informimin dhe ndërgjegjësimin e publikut për këto rreze.

Në vendin tonë i vetmi problem me merkurin konsiston në mbylljen e fabrikës së sodës kaustike (PVC) në Vlorë në vitin 1992, zonë e cila nuk u trajtua në atë kohë për mbetjet e rrezikshme të merkurit të krijuara gjatë veprimtarisë së fabrikës. Si rrjedhojë, kjo zonë ka qenë në qendër të vëmendjes të disa projekteve studimore për vite me radhë. Studimet e para për këtë zonë i përkasin vitit 2002, kur u identifikua si një hot-spot, për të vijuar më tej në 2004, 2008, 2012 dhe së fundi në 2016.

Me mbështetjen financiare të Fondit Global për Mjedisin (GEF), gjatë periudhës 2016 - janar 2019, ministria përgjegjëse për mjedisin, në bashkëpunim me UNDP, zbatuan në vend projektin “Vlerësimi fillestar i Minamatës”, i cili synoi përsheptimin e përgatitjeve të Shqipërisë për ratifikimin e konventës së Minamatës dhe përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin prej saj.

Dispozitat e marrëveshjes respektojnë Kushtetutën dhe parimet e saj. Gjithashtu, ato respektojnë dhe zhvillojnë të drejtat e fituara në koherencë me zhvillimet ekonomike e financiare të vendit. Këto dispozita respektojnë parimet buxhetore të financimit të shpenzimeve të përcaktuara në ligjin për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, si edhe të dispozitave ligjore në fushën e administrimit financiar e kontrollit.

Si përfundim, duke u bërë palë në konventën e Minamatës “Për merkurin”, shtetet anëtare mund të përfitojnë nga fondet në kuadër të programit të veçantë për të mbështetur forcimin institucional në nivel kombëtar për të rritur zbatimin e konventave të Bazelit, Roterdamit dhe Stokholmit, Konventës së Minamatës dhe Qasjes Strategjike për Menaxhimin Ndërkombëtar të Kimikateve (SAICM).

III. ÇËSHTJE TË DISKUTUARA NË KOMISION

Gjatë shqyrtimit të projektligjit në komision nga relatori u vlerësua ndërmarrja e kësaj nisme ligjore, e cila synon synon të finalizojë procesin e ratifikimit të konventës së Minamatës “Për merkurin”, detyrim ky që rrjedh në kuadër të angazhimeve kombëtare dhe ndërkombëtare që vendi ynë ka në lidhje me adresimin e problematikave për merkurin.

Një çështje tjetër e diskutuar në komision lidhet me pyetjen e relatorit Cyrbja nese ka ndonjë të dhënë Ministria përgjegjëse për Mjedisin mbi mbetjet e rrezikshme të merkurit të krijuara gjatë veprimtarisë së fabrikës së sodës kaustike (PVC) në Vlorë. Si edhe si janë adresuar më

konkretisht mbetjet dhe a përbëjnë ato rrezik në të tashmen, por edhe në të ardhmen për banorët e zonave përreth.

Një tjetër çështje e diskutuar në komision lidhet me pyetjen e relatorit Çyrbja nëse është zhvilluar ndonjë studim konkret dhe specifik mbi efektet financiare në kuadër të përfitimeve për asistencë teknike nga ratifikimi i kësaj marrëveshjeje.

IV. PËRFUNDIM

Në përfundim të shqyrtimit të këtij projektligji, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, pasi vlerësoi se:

- a) Në aspektin ligjor, projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;
- b) Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit;

dhe pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, me votat e të gjithë anëtarëve të pranishëm e miratoi atë, dhe u shpreh dakord për kalimin për votim në seancë plenare.

RELATORI

KRYETARI

JURGIS ÇYRBJA

ULSI MANJA